

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të pandehurës B. M. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1506/17 të datës 31.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt. 25.01.2018 në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

E pandehura **B.M.** nga babai R. dhe nëna H. – e lindur B., e lindur më dt. ... në ..., ku edhe jeton, rr. “ ... ” nr. ..., e martuar, nënë e dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin ekonomik, punon si profesororeshë në shkollë, e gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani e pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për veprë tjetër penale, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse më dt.16.08.2017 rreth orës 14:00 në Gjilan, në rr. “ ... ” afër kompleksit të argjendarëve, duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “ ... ” me ngjyrë të bardhë, me targa të regj. ..., ka shkelur paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit Nr. 05/L mbi Rregullat e Trafikut Rrugor dhe ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që nuk i është përmbajtur dispozitave të lartpërmendura të ligjit në fjalë që kanë të bëjnë me obligimin e shoferit sipas të cilit “shoferi i cili në rrugë ose ndonjë hapësirë tjetër të trafikut synon të bëjë ndonjë veprim me mjet, si: hyrjen në trafik, rreshtimin, lëvizjen e mjetit në anën e djathtë ose të majtë, ndërrimin e shiritit të trafikut, tejkalimin, anashkalimin, ndalimin e mjetit, kthimin në anën e djathtë apo të majtë, kthimin gjysmë rrethor, drejtimin e mjetit mbrapa e të ngjashme, lejohet të fillojë një veprim të tillë vetëm nëse më parë është i bindur se nuk e rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit e tjerë në trafik ose nuk e rrezikon pasurinë” lehtë ka menduar se edhe përkundër këtyre lëshimeve nuk do të shkaktoj pasojë të ndaluar, ashtu që me të arritur në vendin e përmendur, për shkak të mos përshtatjes së shpejtësisë kushteve të rrugës nuk arrin që automjetin ta ndalë para çdo pengese që i paraqitet në rrugë dhe për pasojë me pjesën e përparme të automjetit e godet në anën e majtë çiklistin-tani të dëmtuarin Xh.N. nga fsh. ..., kom. Gjilan, i cili në momentin kritik me biçikletën e tij ishte duke kaluar (trupuar) rrugën në vendkalimin për këmbësorë, me ç’rast përveç dëmit material në vlerë të papërcaktuar, këtij të dëmtuari i kishte shkaktuar edhe lëndime të lehta trupore në

formë gërvishtjesh dhe mavijosje në regjionin e nën gjurit të majtë dhe me pasoja të përkohshme për shëndetin.

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr. 6 lidhur me paragr. 1 të KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 23,41,46,73 dhe 75 KPRK si dhe nenit 233 dhe 365 KPPK të pandehurës i shqipton

DËNIMIN ME GJOBË

I. Të pandehurit i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 100 (njëqind) € të cilin dënim e akuzuara është e obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu, ashtu që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të llogaritet një ditë burgu.

II. I dëmtuari Xh,N. nga fsh. ... për realizimin e kërkesës pronëso- juridike është udhëzuar në kontestin civil.

III. E pandehura obligohet që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. E pandehura obligohet që në bazë të nenit 39 paragr.3 pika 1të Ligjit për Kompensimin e viktimave të Krimit, në emër të taksës të paguaj shumën prej 30 €.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën kundër të pandehurës B.M. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK, duke i propozuar gjykatës që të pandehurën ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Në seancën fillestare të mbajtur më dr. 25.01.2018, nga ana e prokurorit të shtetit është bërë leximi i aktakuzës PP.II.nr. 1506/17 të dt. 31.08.2017, ku pas leximit të aktakuzës e pandehura B.M. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Në seancën fillestare gjykatësja e vetme gjykuese mori aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, pasi që konstatoi se për këtë gjë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjyqtarja e vetme konstatoi se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi është bërë me vullnetin e të pandehurës; pranimi është i bazuar me faktet lëndore të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Konform kësaj, gjyqtarja e vetme vërtetoi gjendjen faktike si vijon:

- se e pandehura B.M. ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit.

Me nenin 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 është paraparë që “kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor, do të ndëshkohet sipas ligjit”.

Në bazë të cekurave të mësipërme, gjykata vendosi që të pandehurën B.M. ta shpallë fajtorë për veprën e kryer penale pasi që në veprimet e të njëjtës përmbahen të gjitha rrethanat e kësaj vepre penale dhe se për këtë vepër është penalisht përgjegjëse.

Në bazë të nenit 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të pandehurës, gjykatësja e vetme gjykuese mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë më llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana lehtësuese mori parasysh se e pandehura është e re, nënë e dy fëmijëve, se deri më sot nuk ka qenë e gjykuar, se është penduar për kryerjen e veprës penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të asnjë lloji. Nga rrethanat rënduese mori parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe faktin se kjo vepër është mjaft e shpeshtë në komunikacion.

Sipas bindjes së gjyqtares së vetme dënimi me kusht i shqiptuar kundër të pandehurës B.M. paraqet një dënim të drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë për të pandehurën.

Gjykatësja e vetme konstatoi se edhe me dënimin e tillë mund të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 të KPRK që e pandehura në të ardhmen mos të kryej vepra penale, të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marr në bazë të nenit 453 KPPK.

Vendimi mbi kërkesën pronëso-ro-juridike është marr në bazë të nenit 463 KPPK.

Në bazë të cekurave të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.905/2017 dt. 25.01.2018**

*Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçeviq*

*Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajllloviq*

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi-t të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

*Përktheu –
Naile Keçmezi*